



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

№ 11858 Prot

Tiranë, më 27.12.2017

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**

Për publikim: Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 “Për personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin:

- **Specialist** në Sektorin e Sistemeve dhe Sigurisë, në **Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit**, Kategoria C1, Kategoria e pagës III- b (një vend)

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

- Instalon, menaxhon dhe mirëmban sistemin e videosurvejimit në Administratën Doganore Shqiptare.
- Monitoron sistemin e videosurvejimit, analizon, zbulon, raporton dhe zgjidh problematika të sistemit të videosurvejimit në nivel qendror dhe lokal.
- Kontrollon në mënyrë periodike gjëndjen, infrastrukturën e rrjetit të kamerave (pajisjet dhe lidhjet fizike/logjike mes tyre) në bashkëpunim me Administratorin e rrjetit në degën dhe pikat doganore përkatëse
- Mirëmban dhomën e serverave duke siguruar parametra normalë pune sipas rregulloreve të përcaktuara.
- Instalon, mirëmban dhe konfiguron rrjetin LAN të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Mirëmban, menaxhon sigurinë e sistemeve me anë të niveleve të aksesit të hoste-ve

(përmes firewall-eve dhe politikave të sigurisë kibernetike të institucionit etj), firewall-et e intranetit dhe internetit në nivel qendror dhe lokal.

- Krijon, kur është e nevojshme, tunele të sigurta komunikimi (Virtual Private Network) me Degë, Pika Doganore apo dhe institucione të tjera shtetërore për shkëmbimin e të dhënave sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit.
- Mbështet specialistët/administratorë e rrjetit në Degë Doganore në mirëmbajtje dhe konsulencë teknike mbi pajisjet e rrjetit, pajisjet firewall dhe lidhjet me VPN.
- Merr pjesë në projekte të ndryshme të shkëmbimit të të dhënave mes ADSH dhe Administratave Doganore të vendeve të tjera.
- Instalon Sisteme, mirëmban dhe menaxhon serverat Domain dhe Mail Server në funksion të përmirësimit të punës së Administratës Doganore.
- Realizon dhe mbikqyr Proçedurat e *Backup*-it për serverat Domain, Mail Server, FireWall, Switch dhe të gjithë sistemeve të tjerë nën mirëmbajtje të tyre.
- Krijon, fshin, menaxhon usera-t në MailServer. Krijon, fshin, menaxhon usera dhe direktori, etj në Domain.
- Mirëmban dhomën e serverave duke siguruar parametra normalë pune sipas rregullores së përcaktuar.
- Përbush dhe detyra të tjera të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm, Shefi i Departamentit dhe Drejtori i Drejtorisë që kanë lidhje me natyrën e punës së specialistit.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

Kriteret minimale:

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

Kriteret e veçanta:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Profesional” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat kompjuterike, informatike, inxhinieri elektronike, ekonomi informatike.
- Të ketë mbi 2 vjet eksperiencë pune në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 06.10.2017 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e të ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Belinda Ikonomi

